



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 64 prot.

Kamëz, më 19.05.2022

V E N D I M

Nr. 54 .Datë 19/05 2022

MBI

**“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA
ADMINISTRATORËT SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-
NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.05.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.51 Datë 16.05.2022 mbështetur në Ligjin 57. Datë 18.07.2019” Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimets hoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave“ Pë rpërcaktimin e kriterëve , të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar kreu IV, pika 3, të VKM nr. 597 dt., 04.09.2019 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” dhe në VKB nr. 18 datë 18.02.2022 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”. Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së muajit Prill 2022, prej 60 familjeve që janë rekomanduar nga administratorët shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
Fondi për këto familje është 233,498 (dyqind e tridhjetë e tremijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Kryetar Këshilli
HYSEN KOLDASHI